

AVTOMAGISTRALI TCHERNO MORE – DEGE E SHOQERISE SE HUAJ

PASQYRAT FINANCIARE

PER PERIUDHEN NGA DATA 1 JANAR 2020

DERI ME 31 DHJETOR 2020

PERMBAJTJA:

FAQJA

PASQYRAT FINANCIARE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3-4
PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	6
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	7
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	8-17

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Pasqyra e Pozicionit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

	Shenime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktivet Afatshkurtra			
Aktivet monetare	4	262,946	557,260
<i>Banka</i>		<i>262,946</i>	<i>557,260</i>
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme		84,016,499	166,970,870
<i>Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	5	<i>83,450,564</i>	<i>166,901,127</i>
<i>Te tjera</i>	6	<i>565,935</i>	<i>69,743</i>
Inventaret		-	-
Shpenzime te shtyra		-	-
Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara		-	-
Totali Aktiveve Afatshkurtra		84,279,445	167,528,130
Aktivet Afatgjata		-	-
Aktive financiare		-	-
Aktivet materiale		-	-
Aktivet biologjike		-	-
Aktive jo materiale		-	-
Aktive tatimore te shtyra		-	-
Totali Aktiveve Afatgjata		-	-
Totali i Aktiveve		84,279,445	167,528,130

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Pasqyra e Pozicionit Financiar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

	Shenime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime Afatshkurtra		76,192,831	151,873,215
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	7.1	75,675,048	149,527,337
Te pagueshme ndaj administratorit		510,529	502,564
Te pagueshme ndaj punonjese dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetsore		7,254	21,762
Te pagueshme per detyrime tatimore	7.2	-	1,821,552
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	8	148,440	121,770
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione	9	207,354	207,354
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		76,548,625	152,202,339
Detyrime Afatgjata		-	-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatimore te shtyra		-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata		-	-
Totali i Detyrimeve		76,548,625	152,202,339
Kapitali			
Fitimi i pashperndare		15,325,791	-
Transferimi i fitimit		(5,243,420)	(41,960,224)
Fitimi i vitit		(2,351,551)	57,286,015
Totali i Kapitalit		7,730,820	15,325,791
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		84,279,445	167,528,130

Keto Pasqyra Financiare jane hartuar nga Deloitte Albania shpk dhe jane miratuar dhe nenshkruar nga perfaqesuesi ligjor i Shoqerise Avtomagistrali Tchernomore, Dege e Shoqerise se Huaj me date 16 .
02 . 2021

Hartuesi

Deloitte Albania Shpk
DELOITTE ALBANIA
 Rr. "Fak Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010 Tiranë
 Tirana - Albania
 Tel: +355 44517 920/ Fax: +355 4 45 17990
 NIPT: J 62329003 N

Perfaqesuesi Ligjor

Asen Tomaj

L71415013A

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj

Pasqyra e performances dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë për periudhën deri më 31 dhjetor 2020

(Shumat në LEK)

Shenime	Per periudhën deri më 31 dhjetor 2020	Per periudhën deri më 31 dhjetor 2019
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	701,158,858
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	-	-
Lenda e parë dhe materiale të konsumueshme	-	-
Sherbime nga nenkontraktoret	-	(627,537,172)
Shpenzime të personelit	(162,884)	(261,144)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	(97,497)	(156,312)
Shpenzime të tjera	(65,387)	(104,832)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjatë materiale	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-	(81,874)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12 (1,503,561)	(4,174,442)
Te ardhura të tjera	-	-
Shpenzime financiare	13 (685,106)	(1,457,635)
Shpenzime të tjera financiare	(685,106)	(1,457,635)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	-	-
Fitimi para tatimit	(2,351,551)	67,646,591
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14 -	(10,360,576)
Fitimi i vitit	(2,351,551)	57,286,015
Te ardhura të tjera gjithëpërshiresë për vitin	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërshiresë për vitin	(2,351,551)	57,286,015

Pasqyra e performances dhe te ardhurave të tjera gjithëpërshiresë duhet lexuar së bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 17, të cilat janë pjesë perberëse e Pasqyrave Financiare.

Avtomagistrali Tcherno More – Dege e Shoqerise se Huaj
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

	Kapitali i nenshkuar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivleresimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva te tjera	Fitimet e Pashperndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i ridekluaruar me 1 janar 2018	-	-	-	-	-	-	(1,196,988)	-	(1,196,988)
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	80,261,704	80,261,704
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2018	-	-	-	-	-	-	(1,196,988)	80,261,704	79,064,716
Pozicioni financiar i ridekluaruar me 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-	79,064,716	-	79,064,716
Transferimi i fitimit	-	-	-	-	-	-	(79,064,716)	(41,960,224)	(121,024,940)
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	57,286,015	57,286,015
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	-	-	-	15,325,791	15,325,791
Pozicioni financiar i ridekluaruar me 1 janar 2020	-	-	-	-	-	-	15,325,791	-	15,325,791
Transferimi i fitimit	-	-	-	-	-	-	-	(5,243,420)	(5,243,420)
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-	(2,351,551)	(2,351,551)
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2020	-	-	-	-	-	-	15,325,791	(7,594,971)	7,730,820

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17, ie cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shqerise se Huaj
Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare per periudhen deri me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

	Shenime	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2020	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2019
Fluksi i mjeteve monetare perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit			
<i>Fitimi i vitit</i>		(2,351,551)	57,286,015
Rregullimet per shpenzimet jomonetare:			
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		-	81,876
<i>Tatimi mbi fitimin i parapaguar</i>	14	(251,985)	8,539,024
Rregullime ne te drejtat dhe detyrimet aktuale:			
<i>Renie/(rritje) ne te drejtat e arketueshme</i>	5, 6	82,954,371	155,300,924
<i>Rritje/(renie) ne detyrimet e pagueshme</i>	7.1	(73,844,324)	(86,297,306)
<i>Rritje/(renie) ne detyrime per punonjesit</i>		(14,508)	1,673
<i>Rritje/(renie) ne detyrime tatimore</i>	7.2	(1,569,567)	(19,685,691)
<i>Rritje/(renie) ne shpenzime te konstatuara</i>	8	26,670	117,853
<i>Rritje/(renie) ne provizione</i>		-	207,354
Mjetet monetare neto perdorur ne aktivitetet e shfrytezimit		4,949,106	115,551,721
Fluksi i mjeteve monetare perdorur ne aktivitetin e investimit			
Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e investimit		-	-
Fluksi i mjeteve monetare perdorur ne aktivitetin e financimit			
<i>Transferimi i fitimit</i>		(5,243,420)	(121,024,940)
Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e financimit		(5,243,420)	(121,024,940)
Rritje/(renie) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare		(294,314)	(5,473,219)
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 1 janar 2020		557,260	6,030,479
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me 31 dhjetor 2020		262,946	557,260

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 17 te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj (ne vijim referuar si “Dega”) eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 15 shkurt 2017 me NIPT L71415013A, si dege e shoqerise se huaj, e cila vepron sipas Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar. Objekti i veprimtarise se Deges eshte ndertimi, remontimi dhe mirembajtja e rrugeve dhe e pajisjeve rrugore, te nderlidhjeve qytetare dhe te infrastruktures rreth tyre. Dega mund te operoje ne fushen e prodhimit te te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit dhe inerteve si edhe te produkteve prej tyre. Veprimtaria e Deges eshte e lidhur edhe me studime, projekttime, investime inxhinierike dhe tregtare brenda dhe jashte vendit si dhe cdo lloj sherbimi qe nevojitet per teknike ndertimi dhe teknika te tjera.

Perfaqesues ligjor i Deges eshte Z. Asen Todorov, shtetas Bullgar.

Shoqeria meme eshte **Avtomagistrali Tchernomore AD**, nje shoqeri aksionare me kapital 6,750,000 Leva Bullgare, e themeluar ne Bullgari me 1 qershor 1967.

Ne muajin nentor te vitit 2020, dega u shpall fituese e kontrates per “Rehabilitimin e rruges Vlore – Orikum (10.6 km)”, me numer reference ne kontraten e punimeve EBRD/RLRCP/W/2020/1. Projekti eshte financuar nga Banka Europiane per Rindertimin dhe Zhvillimin dhe do te zbatohet me partneret shqiptare te deges, Arifaj sh.p.k., Denis-05 sh.p.k. dhe Eurokos Holding sh.p.k. Kohezgjatja e projektit do te jete 1 (nje) vit dhe pritet te perfundoje ne fund te vitit 2021.

Me 31 dhjetor 2020, Dega ka te deklaruar vetem perfaqesuesin ligjor.

Person pergjegjes per hartimin e pasqyrave financiare eshte shoqeria Deloitte Albania shpk me NIPT J62329003N, adrese ne Rruga Faik Konica, Ndertesha Nr 6, Hyrje Nr 7, 1010, Tirane e regjistruar prane Institutit te Kontabilistev te Miratuar (IKM) me perfaqesues ligjor Znj. Violeta Perleka, kontabilist i miratuar me Nr.License 614.

2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e pajtueshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (SKK) dhe ne baze te Ligjit 25/2018, date 10.05.2018, “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Vijimesia

Pasqyrat financiare te Deges pergatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se Dega do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te paparashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare individuale jane pergatitur dhe paraqitur ne Lek.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe Drejtimi i Deges te kryeje vleresime dhe supozime qe ndikojne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel.

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Deges dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerine per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Drejtimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen. Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale.

Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte:

2.6 Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme

Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara te cilat rezultojne nga pamundesia per te paguar detyrimet. Keto vleresime bazohen ne moshen e te drejtave te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne cregjistrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses. Drejtimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojë per zhvleresim te tyre.

2.7 Provizionet

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e ceshtjeve gjyqesore. Dega vlereson mundesine e krijimit te detyrimit aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%. Ne te tilla raste Dega provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatit e ceshtjes. Drejtimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojë per krijimin e provizioneve.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehene ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 eshte detajuar si me poshte:

Kursi i kembimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123.70	121.77

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiar perbehen nga mjetet monetare, instrumenta borxhi (si llogari, deftesa ose hua te arketueshme ose te pagueshme), dhe nga zotime per te marre hua, te cilat plotesojne kushtet e instrumentave te borxhit.

Nje instrument financiar njihet nese Dega behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Instrumentat financiar njihen fillimisht me koston e transaksionit (duke perfshire edhe cmimin e transaksionit). Kostoja eshte (a) vlere e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlere e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij; (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlere e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.

Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojne/shlyhen te drejtat kontraktuale te Deges ndaj flukseve te parase nga aktiviteti financiar ose kur Dega transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbeshore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare regjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Deges shlyhen, anulohen ose skadojne.

Aktivitetet monetare

Aktivitetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivitetet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Te drejtat e arketueshme

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizionit per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Dega nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transaksioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivitetit dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivitetin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

3.3 Inventaret

Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te ulet mes koston dhe cmimit te vleresuar te shitjes i pakesuar me koston per te perfunduar. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare.

Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renes ne vlere te inventareve deri ne cmimin e vleresuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga zhvlerimi. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qelimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e montimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjat material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim ne periudhen kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitetit afatgjat material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit.

Jetegjatesia e vleresuar per vitin aktual eshte si me poshte:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlere e mbetur	20%
Pajisje Zyre	Vlere e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlere e mbetur	25%
Instrumenta dhe Vegla Pune	Vlere e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlere e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

iv. Cregjistrimi

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi. Fitimi dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas vleres se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

3.5 Aktivet dhe detyrimet e kushtezuara

Aktivitetet e kushtezuara nuk paraqiten ne pasqyrat financiare, por paraqiten ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per aq kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes.

3.6 Te ardhurat

Te ardhurat njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur produktet dhe sherbimet jane perfunduar, kryer, ne perputhje me SKK 8 Te ardhurat.

Ne rastet kur rezultati i nje transakcioni qe perfshin ofrimin e sherbimeve mund te matet me besueshmeri, te ardhurat e lidhura me kete transakcion njihen ne varesi te fazes se perfundimit te sherbimit ne fund te periudhes se raportimit.

3.7 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit perfthohen jashte rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike, duke perfshire fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet ne llogarite/kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per t'u paguar furnitoreve (nese rezulton nje humbje neto, ajo njihet ne zerin "Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit").

3.8 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

3.9 Shpenzime te personelit

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet Fiskale jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Deges ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Dega ka deklaruar, perlllogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsores ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsores", si dhe Udhезimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, mesatarisht per 2 punemarres gjate vitit 2020.

3.10 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit.

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 ne fuqi per "Tatimin mbi te ardhurat". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjitha barren per vitin korrent. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin financiar 2020 eshte 15 % (2019: 15%).

3.11 Transaksionet me palet e lidhur

Njesite konsiderohen si te lidhura, nese njera pale ose kontrollon palen tjeter ose ka nje ndikim te ndjeshem ekzistues kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ate te shfrytezimit. Palet jane te lidhura edhe kur ato jane nen kontrollin e perbashket te nje njesie tjeter. Per qellime te pasqyrave financiare Drejtimi i Deges dhe Shoqeria Meme konsiderohen pale te lidhura.

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

4. Aktivet monetare

Aktivete monetare me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Banka ne monedhe te huaj	258,926	521,026
Banka ne monedhe vendase	4,020	36,234
Totali	262,946	557,260

5. Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	83,450,564	166,901,127
Totali	83,450,564	166,901,127

6. Te drejta te arketueshme

Te drejtat e arketueshme me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatimi mbi vleren e shtuar	313,950	-
Tatimi mbi fitimin	251,985	-
Totali	565,935	-

7.1. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Llogari te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
EuroKos Holding, Dega ne Shqiperi	24,916,549	49,791,818
Denis - 05 sh.p.k.	24,895,626	49,791,535
Arifaj sh.p.k.	24,896,731	49,793,155
Deloitte Albania sh.p.k.	748,127	146,113
Komisione garancie	218,015	-
ALBtelecom sh.a.	-	4,716
Totali	75,675,048	149,527,337

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

7.2. Te pagueshme per detyrime tatimore

Te pagueshme per detyrime tatimore me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatimi mbi fitimin	-	1,821,552
Totali	-	1,821,552

Dega gjate vitit 2020 nuk ka kryer aktivitet ekonomik, dhe nuk ka realizuar te ardhura e per rrjedhoje nuk ka detyrime per tatim fitimi.

8. Te pagueshme per shpenzimet e konstatuara

Te pagueshme per shpenzimet e konstatuara me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitore per fatura te pamberitura	148,440	121,770
Totali	148,440	121,770

9. Provizione

Provizione me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Provizione per gjoba	207,354	207,354
Totali	207,354	207,354

10. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020, dega nuk ka realizuar te ardhura nga punime dhe sherbimeve, ndersa per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 ka realizuar punime dhe sherbime ne shumen 701,158,858 Leke, te cilat njihen ne baze te fazes se perfundimit te sherbimit ne fund te periudhes se raportimit.

11. Sherbime nga nenkontraktoret

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020, dega nuk ka marre sherbime nga nenkontraktoret, pasi nuk ka kryer aktivitet ekonomik. Ndersa per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019, ka marre sherbime ne shumen 627,537,172 Leke, te cilat perbejne koston e projektit per qelimin e realizimit te objektit te kontrates.

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

12. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzime te tjera shfrytezimi per periudhen deri me 31 dhjetor 2020 dhe deri me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2020	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2019
Sherbime kontabiliteti	988,267	1,688,719
Sherbime konsulence ligjore	258,468	298,047
Shpenzime garancie	172,019	378,653
Taksa dhe tarifa vendore	43,500	69,583
Shpenzime bankare	21,951	96,944
Shpenzime telefonie	18,684	36,581
Gjoha, penalitete dhe kamatevonesa	672	322,549
Shpenzime qeraje	-	552,850
Shpenzime per karburantin	-	255,813
Shpenzime te tjera	-	172,587
Shpenzime kancelarie	-	153,821
Shpenzime akomodimi	-	70,440
Shpenzime interneti	-	37,787
Shpenzime per autovetura	-	21,400
Mirembajtje te sistemeve informatike	-	18,668
Totali	1,503,561	4,174,442

13. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare qe rezultojne nga ndryshimet e kurseve te kembimit per periudhen deri me 31 dhjetor 2020 dhe deri me 31 dhjetor 2019 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2020	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2019
Fitime nga kembimet dhe perkthimet valutore	5,898,896	13,980,327
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	(6,584,002)	(15,437,962)
Totali	(685,106)	(1,457,635)

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se Huaj
Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
(shumat ne LEK)

14. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin per periudhen deri me 31 dhjetor 2020 dhe deri me 31 dhjetor 2019 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2020	Per periudhen deri me 31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	(2,351,551)	67,646,591
<i>Shpenzime te panjohura</i>	84,744	1,423,916
Fitim neto i vitit	(2,266,806)	69,070,507
Humbje fiskale e mbartur nga viti i kaluar	-	-
Fitimi i tatueshem	(2,266,806)	69,070,507
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	10,360,576
Tatim fitimi i parapaguar	251,985	8,539,024
Tatim fitimi per t'u paguar	-	1,821,552

15. Ngjarje te metejshme

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.

INVENTARI I MALLRAVE

31.12.2020

Subiekti
NIPT-I

Avtomagistrali Tchernomore – Dege e Shoqerise se huaj
L71415013A

Aktiviteti

Objekti i veprimtarise se Deges eshte ndertimi, remontimi dhe mirembajtja e rrugeve dhe e pajisjeve rrugore, te nderlidhjeve qytetare dhe te infrastruktures rreth tyre. Dega mund te operoje ne fushen e prodhimit te te gjitha llojeve te materialeve te nderimit dhe inerteve si edhe te produkteve prej tyre.

Adresa Vep.
Telefoni

Rruga Faik Konica, Ndertesa nr. 6 Hyrja nr. 7, 1010, Tirana, Albania

Nr.	Artikulli	Nj/M	Sasia	Kosto/njesi	Vlera
	-	-	-	-	-
Shuma		-	-	-	-

Administratori i Shoqerise
Asen Todorov



INVENTARI I AUTOMJETEVE NE PRONESI TE SUBJEKTTIT

31.12.2020

Subjekti
NIPT-I

Avtomagistrali Tcherno More – Dege e Shoqerise se huaj
L71415013A

Aktiviteti

Objekti i veprimtarise se Deges eshte ndertimi, remontimi dhe mirembajtja e rrugeve dhe e pajisjeve rrugore, te nderlidhjeve qytetare dhe te infrastruktures rreth tyre. Dega mund te operoje ne fushen e prodhimit te te gjitha llojeve te materialeve te nderimit dhe inerteve si edhe te produkteve prej tyre.

Adresa Vep.
Telefoni

Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr. 7, 1010, Tirana, Albania

Nr.	Lloji Automjeteve	Kapacitet	Targa	Vlera
	-	-	-	-
Shuma				-

Administrator i Shoqerise
Asen Todorov



SHOQERIA: Avtomagistrali Tchernom More – Dege e Shqerise se huaj
NIPTI: L71415013A

Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2020

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2020	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri, paisje, vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Amortizimi A.A.Materiale 2020

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2020	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri, paisje, vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2020

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2020	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2020
1	Toka	-	-	-	-	-
2	Ndertime	-	-	-	-	-
3	Makineri, paisje, vegla	-	-	-	-	-
4	Mjete transporti	-	-	-	-	-
5	Pajisje Kompjuterike	-	-	-	-	-
6	Pajisje Zyre	-	-	-	-	-
7	Te tjera	-	-	-	-	-
	TOTALI		-	-	-	-

Administrator / Shqerise
Asen Todorov

